

Data \_\_\_\_\_

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtje sistemi i menaxhimit të radhës dhe sistemit CCTV për KNK, 3 vjecare”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT 48614000-5 - Sistem i marrjes së të dhënave.**

VLERA E FONDIT LIMIT: - 74,903,619 (shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e tre mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) leke, pa TVSH.  
- 712,621.2 (shtatë milion e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e një pikë dy) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 03.11.2023 1 euro = 105.11 All.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:**

Ne zbatim te Paragrafit 2 Pika 1 e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme sepse nga vete objekti i prokurimit kemi te bejme me nje sistem qendror i cili bazohet dhe karakterizohet nga nderlidhja e pashmangshme e disa zgjidhjeve teknologjike prodhuesish, duke bere te mundur vetem ofrimin garancive dhe suportit, si dhe zgjerim dhe permiresim te sistemit aktual. Ndarja ne lote do ta bente te pa ekezekutueshme kontraten pasi eshte nje sistem kompleks dhe i perqendruar.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 33, të ligjit 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021,2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 74,903,619 (shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e tre mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) leke pa TVSH.

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021,2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rendesine e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare

e xhiros për tre apo me pak vitet e fundit financiare te jete ne masën 74,903,619 (shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e tre mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) leke pa TVSH.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar nenin 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 29,961,000 (nëzet e nente milion e nentëqind e gjashtëdhjetë e një mijë) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është

kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatorëve ekonomik që ofrojnë këto lloje produktesh/shërbimesh, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të produkteve/shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurrencës që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë/realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 40 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

---

### **1.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare me:**

- a) **ISO 9001:2015** ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme);
- b) **ISO 27001:2013** ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme);
- c) **ISO/IEC 20000-1:2018** ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (e vlefshme);

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes paraprake.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

- a) Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilesore dhe të

plotë, bazuar ne organizimin e brendshem per menaxhimin sa me te mire te cilesise implementuese.

- b) Certifikimi **ISO 27001:2013** ose ekuivalent sherben per te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar eshte ne gjendje te kryeje realizimin e kontrates ne fjale duke siguruar qe informacionet (siç jane ato qe permbajne sistemet ekzistuese te AK dhe qe kane nje rendesi dhe konfidencialitet te larte, te menaxhohen ne menyre te sigurte nga pikepamja informatike dhe te jene te kontrolluara dhe si dhe aksesit te keto sisteme te jete i verifikueshem e i kodifikuar). Kjo vjen pasi ne kete kontrate do kete vijim te mirembajtjes dhe garancise se suportit te te dy sistemeve ekzistuese qe kerkojne kompetence te shtuar profesionale ne kete drejtim, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe ne kategorine e mbrojtjes kibernetike, per aq sa ekspozohen sistemet ne fjale.
- c) Certifikimi **ISO 20001-1:2018** ose ekuivalent sherben per te verifikuar dhe garantuar qe OE i interesuar eshte ne gjendje te kryeje realizimin e kontrates ne fjale duke qene se zoteron nje sistem menaxhimi per sherbimet e teknologjise se informacionit, duke pasur me shume garanci qe ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë te dy sistemet qe kerkohen ne DST, te cilet jane teresisht te bazuar ne produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe ne kategorine e mbrojtjes kibernetike.

**2.** Për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE/BOE dhe për përmbushjen me sukses të kontratës, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë Autorizim nga Prodhuesi/Distributori i autorizuar (ku te provohet lidhja e prodhuesit me distributorin), për shërbimin e suportit te Garancive per sistemet ekzistuese te autoritetit kontraktor (referuar specifikimeve teknike).

#### **Argumentimi:**

Autorizimi i prodhuesit/distributorit te autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së licensave/suporteve specifike të garancise që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre licensave/suporteve specifike të garancise. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve/sherbimeve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve bashkekohore nga prodhues me fame te mire boterore dhe të zyrtarizuar ne praktikat e tyre te veprimtarise tregtare. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vertetur se disponojnë autorizimet perkatese per furnizimin e licensave/suporteve specifike të garancise, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributoret perkates si dhe qe do vijojne për të zbatuar kushtet e garancisë. Duke qene se nje pjese e prokurimit eshte per suportet e garancise per vazhdimesine e dy sistemeve ekzistuese qe jane funksionale, kane akoma rendesi dhe vlere materiale te konsiderueshme per AK, atehere kerkohet siguri nga OE qe te vertetoje lidhjen e tij me Prodhuesin/Distributorin perkates te kanalit zyrtar, ne menyre qe te kene te drejta per te rishitur keto licensa/suporte garancie, ne menyre qe te sigurohet vazhdimesia e procesit nga te njejtet prodhues.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin me sukses të kontratës, duhet të ketë të punësuar për muajin e Tetor 2023 jo më pak se 10 punonjës dhe të disponojë si staf të tij personelin kryesor teknik, si më poshtë:

*a) Minimumi 1 (nje) punonjës të pajisur me Certifikate për Menaxhim Projektësh PMP ose ekuivalente;*

*b) Minimumi 2 (dy) inxhinier elektronik / telekomunikacioni të certifikuar nga Prodhuesi i Sistemit CCTV për instalim konfigurim dhe mirembajtje të paisjeve CCTV. (të paraqitet edhe diploma perkatese bachelor + Master i të njejtës fushe ose ekuivalenti i saj/tyre);*

*c) Minimumi 3 (tre) specialist TIK të certifikuar nga Prodhuesi i Sistemit CCTV për instalim dhe mirembajtje të paisjeve CCTV;*

*d) Minimumi 1 (nje) specialist TIK të certifikuar nga Prodhuesi i Sistemit CCTV për instalim dhe mirembajtje të Software të Monitorimit;*

---

*e) Minimumi 2 (dy) specialist TIK të certifikuar nga Prodhuesi i Sistemit Menaxhim Rradhes për instalim dhe mirembajtje të Software të Menaxhimit të Rradhes dhe të paisjeve të Menaxhimit të Rradhes;*

*f) Minimumi 1 (një) specialist të certifikuar për network në nivel Profesional “CCNP” ose ekuivalent;*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, për të gjithë punonjësit e mesipër si pjesë e stafit të punësuar nga vete OE, duhet të paraqiten sa në vijim edhe:

*1) Çertifikatat perkatese të kualifikimit;*

*2) Listepagesa e punonjësve për muajin Tetor 2023 dorëzuara nepermjet formes elektronike në organet kompetente apo çdo dokumentacion tjetër vertetues, të pakten për muajin e fundit;*

*Nje punonjës mund të ketë një ose disa certifikime, për të përmbushur kriteret e mesipërme për certifikimet.*

Sqarim: përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

---

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

- a) Per kriterin ne piken a) gjykohet se eshte i domosdoshem ne kushtet e madhesise dhe kompleksitetit te realizimit te kontrates, kohezgjatjes te saj (deri ne 3 vjet per garancite e suporteve) dhe rendesise operationale qe kane sistemet ekzistuese te AK, ku te gjitha keto duhet domosdoshmerisht te ndiqen nga nje profesionist i kualifikuar PMP ose ekuivalent ne menaxhimin e projekteve nga fillimi (nenshkrimi i kontrates) deri ne perfundim te saj, ne menyre qe te minimizohet ne maksimum risku i mosrealizimit te kontrates per arsye menaxheriale. Ky lloj certifikimi eshte standard i kerkuar gjeresisht, dhe garanton Autoritetin Kontraktor se OE ka kapacitetet menaxheriale, njohuri dhe ekspertize te thelluar ne menaxhimin e projekteve, kredibilitet profesional si dhe sherben si nje pike referuese nga ana e AK gjate zbatimit te kontrates;
- b) Per kriterin ne piken b) gjykohet se eshte i domosdoshem ne kushtet e madhesise dhe kompleksitetit te realizimit te kontrates si furnizim+vendosje, kohezgjatjes te saj (deri ne 3 vjet per garancite e suporteve) dhe rendesise se zgjidhjes se sakte teknologjike per instalimin e mbikeqyrjen e sistemeve te reja dhe integrimi i mundshem me ato ekzistuese te AK, ku te gjitha keto duhet domosdoshmerisht te ndiqen nga te pakten 2(dy) profesionist te kualifikuar inxhinjerik elektronik/telekomunikacion nga fillimi (nenshkrimi i kontrates) deri ne perfundim te saj, ne menyre qe te minimizohet ne maksimum risku vendosjeve teknologjike te pasakta, duke pasur parasysh dhe shtrirjen ne shume dege dhe godinen qendrore qe perben nje kompleksitet teknologjik më vete;
- c) Per kriterin ne piken c) gjykohet se eshte i domosdoshem ne kushtet e madhesise, kompleksitetit te realizimit te kontrates si furnizim+vendosje per sistemet CCTV, kohezgjatjes te saj (deri ne 3 vjet per garancite e suporteve per nje numer te konsiderueshem ambjentesh ekzistuese te shtrire gjeografikisht ne gjithe Shqiperine dhe shtesat e reja), rendesise qe ka instalimi i sakte dhe kompetent sipas udhezimeve te prodhuesve dhe integrimi i mundshem me ato ekzistuese te AK, ku te gjitha keto duhet domosdoshmerisht te ndiqen nga te pakten 4(kater) specialist te çertifikuar nga prodhuesi respektiv, nga fillimi (nenshkrimi i kontrates) deri ne perfundim te saj, ne menyre qe te minimizohet ne maksimum risku instalimeve teknologjike te pasakta, duke pasur parasysh dhe shtrirjen ne shume dege dhe godinen qendrore qe perben nje kompleksitet teknologjik më vete;
- d) Per kriterin ne piken d) gjykohet se eshte i domosdoshem ne kushtet e madhesise, kompleksitetit te realizimit te kontrates si furnizim+vendosje per sistemet CCTV, kohezgjatjes te saj (deri ne 3 vjet per garancine e suportit edhe per softuerin e monitorimit dhe rikonfigurimet per nje numer te konsiderueshem ambjentesh te reja dhe ekzistuese te shtrire gjeografikisht ne gjithe Shqiperine), rendesise qe ka instalimi e konfigurimi i sakte dhe kompetent sipas udhezimit te prodhuesit respektiv dhe integrimi me ato ekzistuese te AK, ku te gjitha keto duhet domosdoshmerisht te ndiqen nga te pakten 1(nje) specialist te çertifikuar nga prodhuesi respektiv per software, nga fillimi (nenshkrimi i kontrates) deri ne perfundim te saj, ne menyre qe te minimizohet ne maksimum risku i difekteve apo mos sinkronizimeve te sinjaleve CCTV, duke pasur parasysh dhe shtrirjen ne shume dege dhe godinen qendrore qe perben nje kompleksitet teknologjik më vete;

- e) Per kriterin ne piken e) gjykohet se eshte i domosdoshem ne kushtet e madhesise, kompleksitetit te realizimit te kontrates per sistemet ekzistuese te menaxhimit te radhes, kohezgjatjes te saj (deri ne 3 vjet per garancine e suportit dhe mirembajtjen e sistemeve ekzistuese per nje numer te konsiderueshem ambjentesh ekzistuese te shtrire gjeografikisht ne gjithe Shqiperine), rendesise qe ka funksionimi korrekt te cilesia e sherbimit ndaj klienteve te AK, ku keto procese duhet domosdoshmerisht te ndiqen nga te pakten 2(dy) specialist te certifikuar nga prodhuesi respektiv per sisteme menaxhim rradhe, si nga pikepamja hardware ashtu edhe software, nga fillimi (nenshkrimi i kontrates) deri ne perfundim te saj, ne menyre qe te minimizohet ne maksimum koha e mosfunksionimit te ketyre sistemeve;
- f) Per kriterin ne piken f) gjykohet se eshte i domosdoshem ne kushtet e madhesise, kompleksitetit te realizimit te kontrates per te dyja sistemet ekzistuese, CCTV + te menaxhimit te radhes, dhe per blerjet hardware rishtasi qe kerkojne konfigurime specifike ne rrjetin fizik IP Cat 5/Cat6 sidomos ato NVR, te kohezgjatjes te saj per garancine e suportit (deri ne 3 vjet per pajisjet hardware qe kane nderfaqe IP), duke qene dhe nje numer i konsiderueshem ambjentesh ekzistuese te shtrire gjeografikisht ne gjithe Shqiperine), rendesise qe ka funksionimi korrekt ne rrjet informatik i ketyre sistemeve prej te cileve varet monitorimi i cilesise se punes se stafit te AK, qe keto procese/pune duhet domosdoshmerisht te ndiqen nga te pakten 1(nje) specialist te certifikuar per network ne nivel Profesional “CCNP” ose ekuivalent. Kompetenca e tij do te minimizonte ne maksimum problemet e mundshme te komunikimit ne rrjet per te dy sisteme.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuarçdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Termt e References dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.



**SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.**